



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1704/1 Prot

Tiranë, më 06.12.2019

V E N D I M

Nr.156, datë 06.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Libohovë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Libohovë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me Urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Libohovë.

Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Libohovë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhrin nr. 11, datë 14.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë “Për miratimin e strukturës organizative”, e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Libohovë, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **21** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **3** pozicione kategori e ulët drejtuese dhe **18** pozicione të nivelit ekzekutiv. Në këtë institucion nuk konstatohen raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune të shërbimit civil.

Aktualisht institucioni, po punon për hartimin e një strukture të re organizative, përgatitja e të cilës është në proces.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan **12** raste të emërimeve të punonjësve pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, për të cilët rezulton se kanë përfunduar periudhën 1 vjeçare të provës, por nga ana e eprorit direkt, nuk është finalizuar procesi, nëpërmjet nxjerrjes së vendimit për konfirmimin e nëpunësit civil.

Konkretisht, rastet e emërimeve evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, Specialist i Burimeve Njerezore, emëruar me aktin nr. 379/1, datë 13.3.2017;
2. *****, Specialist Arkiv-Protokoll pranuar në shërbimin civil me aktin e nxjerrë në datën 09.08.2016 dhe që nuk ka numër protokolli.
3. *****, Specialist i Ndhmës Ekonomike, pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 943/3, datë 10.08.2016;
4. *****, Specialist i Zhvillimit Urban, pranuar në shërbimin civil me aktin nr.941/1, datë 10.08.2016;
5. *****, Specialist Finance në Sektorin e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 22/1, datë 11.01.2016;
6. *****, Specialist Finance, në Sektorin e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, pranuar në shërbimin civil me aktin nr.23/1, datë 11.01.2016;
7. *****, Specialist Finance, në Sektorin e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, pranuar në shërbimin civil me aktin e nxjerrë në datën 01.11.2018 dhe që nuk ka numër protokolli.
8. *****, Specialist IT, pranuar në shërbimin civil me aktin nr.816/1, datë 2.6.2017;
9. *****, Specialist i Tatim – Taksave pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 496, datë 06.04.2017;

10. ******, Specialist Jurist pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 1795, datë 15.11.2018;
11. ******, Specialist i Bujqësisë pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 1371, datë 25.09.2017;
12. ******, Specialist i Tatim – Taksave pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 128, datë 04.02.2016.

Në këtë rast, nëpunësit e ngarkuar me procesin e konfirmimit (*në cilësinë e eprorit direkt*), duhet të realizojnë procedurat që kanë të bëjnë me përmbylljen e këtij veprimi administrativ me një akt të arsyetuar në përmbajtjen e të cilit do të vendoset sipas nenit 24, të ligjit për nëpunësin civil që rregullon periudhën e provës, i cili parashikon: konfirmimin e nëpunësit civil; shtyrjen e periudhës së provës një herë të vetme për 6 muaj, ose mos konfirmimin e nëpunësit civil.

Në lidhje me punonjësën ******, Specialist Bujqësie, i cili është pranuar në shërbimin civil me aktin nr. 487/1, datë 05.04.2017, rezulton se, megjithëse e ka përfunduar periudhën e provës, ai ende nuk e ka kryer trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike. Në këto rrethana, nga ana e njësisë përgjegjëse duhet të krijohen kushtet që të mundësohet trajnimi i detyrueshëm për këtë punonjës.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit, është vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me procesin e konkurrimit dhe duhet të vijojë finalizimi i procesit të konfirmimit si nëpunës civilë, për personat që kanë përfunduar periudhën e provës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të finalizohet procesi i konfirmimit nga ana e eprorit direkt dhe Njësisë Përgjegjëse për **12** rastet e nëpunësve që kanë kryer periudhën e provës dhe kanë realizuar me sukses trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA- s, të cilët janë evidentuar më sipër, në pjesën arsyetuese të vendimit.

- Të planifikohet trajnimi i detyrueshëm pranë ASPA-s, për punonjës të ***** , emëruar në pozicionin e punës Specialist Bujqësie, pranë këtij institucioni.
 - Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, të njoftojë të gjithë personat e evidentuar në këtë vendim, si dhe eprorët e drejtpërdrejt të tyre për të realizuar detyrat që kanë lidhje me procesin e konfirmimit të statusit të punësimit për punonjës të kanë përfunduar periudhën e provës.
2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 (dy) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Libohovë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 3. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
 4. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Libohovë, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha